



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 18.07.2017

Vendim
Nr. 80, datë 18.07.2017

**“PËR PRANIMET E STUDENTËVE NË TË DY RAUNDET E APLIKIMIT,
PËRLLLOGARITJEN E PIKËVE PËR ÇDO KONKURENT DHE HARTIMIN E
LISTAVE TË KANDIDATËVE FITUES NË BAZË TË PIKËVE TË
GRUMBULLUARA, NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT
TË PARË TË STUDIMEVE QË OFROJNË DEPARTAMENTET E UV-SË PËR
VITIN AKADEMIK 2017-2018”**

Në mbështetje të pikës 8 të nenit 25, “Departamenti”, të nenit 69, “Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë”, respektivisht të pikës 3 të tij: “*Pranimet e studentëve në institucionet e arsimit të lartë në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të institucioneve, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore...*”, të nenit 74, “*Pranimi në ciklin e parë të studimeve*”, të Ligjit 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikave 3, 4 dhe 5 të seksionit B, të Udhëzimit nr. 15 datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, të Vendimit të SA nr. 41 prot, datë 31.03.2017, “Për kriteret dhe kuotat e pranimit të kandidatëve për studentë në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2017-2018”, si dhe në shkresën e MAS nr. 6617 prot, datë 04.07.2017, “Për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.07.2017

VENDOSI:

1. Të pranojë në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve që ofrojnë departamentet e institucionit, kandidatët maturantë për studentë, të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar nga MAS për vitin akademik 2017-2018 si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të shpallura nga Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, për çdo program studimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Programet e studimit të ciklit të parë të studimeve që ofrojnë departamentet e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, janë si më poshtë:

Njesia Baze	Programi i Studimit	Cikli (Bachelor/ Master i Profesional/ Master i Shkencave/ Doktorature)
Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjise Detare	Inxhinieri Mekanike	Bachelor
	Inxhinieri Navale	Bachelor
	Inxhinieri Elektrike	Bachelor
Departamenti i Shkencave Detare	Navigacion	Bachelor
Departamenti i Biologjise	Biologji	Bachelor
Departamenti i Kimise	Kimi	Bachelor
Departamenti i Fizikes	Fizike	Bachelor
Departamenti i Matematikes	Matematike	Bachelor
Departamenti i Shkencave Kompjuterike	Informatike	Bachelor
	Teknologji Informacioni	Bachelor
	Shkenca Kompjuterike	Bachelor
Departamenti i Gjuheve te Huaja	Gjuhe Angleze	Bachelor
	Gjuhe Italiane	Bachelor
Departamenti i Edukimit	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	Bachelor
	Mësuesi për Arsimin Fillor	Bachelor
	Pedagogji e Specializuar	Bachelor
	Histori – Gjeografi	Bachelor
Departamenti i Gjuhe - Letersise	Gjuhe- Letersi	Bachelor
Departamenti i Drejtesise	Drejtesi	Bachelor
Departamenti i Ekonomiksit	Ekonomiks	Bachelor
Departamenti i Biznesit	Administrim Biznesi	Bachelor
	Manaxhim Turizmi	Bachelor
	Marketing	Bachelor
Departamenti i Finances dhe Kontabilitetit	Finance	Bachelor
	Kontabilitet	Bachelor



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Departamenti i Infermierise	Infermieri e përgjithshme	Bachelor
Departamenti i Kujdesit Shendetesor	Infermieri Mami	Bachelor

3. Pranë çdo departamenti të ngrihet një komision i përbërë nga përgjegjësi, tre anëtarë të zgjedhur prej tij dhe tre specialistë IT-je nga Drejtoria e IT-së dhe Statistikave në Rektorat apo në fakultete, respektivisht Z. A. Mahilaj, Z. F. Ziu dhe Z. I. Bitraj. Tre specialistët e IT-së janë anëtarë në të gjitha komisionet e krijuar nga departamentet. Funkzioni i komisioneve të jetë përllogaritja e pikëve për çdo kandidat për student dhe hartimi i listës fituese në bazë të pikëve të grumbulluara, (raundi i parë dhe raundi i dytë) referuar kriterëve të shpallura nga MAS dhe SA për pranim në secilin program studimi. Komisioni i përllogaritjes së pikëve të kandidatëve dhe i hartimit të listave fituese kryesohet nga Përgjegjësi i departamentit. Në bazë të nenit 25, pika 8 e ligjit 80/2015 departamenti është përgjegjës për përzgjedhjen e studentëve fitues.
4. Këto komisione do të punojnë nga data 23 gusht deri në 28 gusht 2017, ditë në të cilën institucioni i raporton QSHA-së dhe afishon listën e renditjes së aplikantëve të raundit të parë dhe nga data 27 shtator deri në 30 shtator 2017 për raundin e dytë.
5. Çdo departament (komisioni përkatës) në bazë të kriterëve të propozuara prej tij dhe të miratuara nga SA si dhe kriterit të notës mesatare miratuar nga MAS për vitin akademik 2017-2018, të shqyrtojë kërkesat dhe të kryejë procesin e përllogaritjes së pikëve për çdo konkurent dhe renditjes së kandidatëve fitues në bazë të pikëve të grumbulluara.
6. Lista e studentëve fitues dhe procesverbali i plotë i të gjitha hallkave të procedurës së ndjekur për renditjen e tyre t'u përcillen drejtuesve të njësive kryesore (Dekanëve të fakulteteve). Mbi bazën e dokumentacioneve të mësipërme dekanët të kryejnë miratimin e listave të studentëve fitues të hartuar në 4 (tre) kopje origjinale (hard copy) dhe elektronike të cilat të administrohen nga: (një) kryesekretaria, (një) departamenti, (një) sekretaria mësimore e departamentit dhe një kopje t'i përcillet Rektorit. Nëse Dekanët nuk e gjejnë legale listën dhe procedurën e ndjekur, me vërejtjet konkrete përkatëse, i kthejnë ato sërish për rishqyrtim tek komisioni i renditjes së studentëve të ngritur pranë departamentit.
7. Ngarkohen dekanët, zëvendësdekanët, komisionet e përllogaritjeve të pikëve të çdo kandidati, përgjegjësat e departamenteve, dhe specialistët e IT-së të respektojnë afatet e vendimarrjeve respektive, raportimeve dhe proceduravetë parashikuara në Udhëzimin e MAS, nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”.

8. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.